REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE DHE TERRITORIT

PROJEKT -VENDIM

Nr. 52 **Datë** 24 / 06 **/2026**

"PËR MIRATIMIN E VEND-DEPOZITIMIT TË PËRKOHSHËM TË MBETJEVE INERTE"

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Neni 8, Pika 2, Neni 64, pika "a", Ligjit Nr. 57/2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", Ligjit Nr.99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërsië" i ndryshuar, Ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011, "Për Lejet e Mjedisit" të ndryshuar, Ligjin 107/2014, date 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, Vendim Nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", për të disiplinuar mbetjet inerte të cilat prodhohen si rezultat i proceseve të ndërtimeve apo prishjeve në territorin e Bashkisë Devoll,

PROPOZOJ:

1. Miratimin e hapësirës së depozitimit sipas hartës bashkëlidhur ketij projekt-vendimit.
2. Të depozitohen jo më tepër se 20 tonë në ditë ose 3500 tonë në vit mbetje inerte.
3. Afati i dorëzimit të mbetjeve inerte në vend-depozitimin e përkohshëm të jetë deri në momentin e ndërtimit të landfillit për trajtimin e mbetjeve inerte në zonën më të afërt gjeografikisht të njësisë së qeverisjes vendore.
4. Për zbatimin e tij ngarkohet Inspektoriati Vendor përgjegjës për ndërtimet që të ushtrojnë kontrolle të vazhdueshme mbi zotëruesit e mbetjeve inerte dhe vend-depozitimet e përkohshme.
5. Ky vendim do të hyjë në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 te Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar

Konceptoi: Marsel Mulla

Konfirmoi Bazën Ligjore:

Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Juridike

Eriksela Avdo

Konfirmoi: Sekretari i Përgjithshëm

Adriana Rushitaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL

KRYETARI I BASHKISË
EDUARD DURO

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com

HARTA E VEND-DEPOZITIMIT TË MBETJEVE INERTE NË BASHKINË DEVOLL



1. Hapesira e depozitimit te inerteve eshte shenuar me ngjyre blu, duke respektuar Nenin 17 te VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 ku kufizohen zonat në distancë 100 metra nga një përrua, argjinaturë lumore, liqen, lum ose kompleks ligatinor.
2. Koordinatat sipas KRGJSH te hapesires se depozitimit jane:
   1. E. 581729.20 N. 4499579.18;
   2. E. 581736.90, N. 4499621.88;
   3. E. 581594.80, N. 4499663.88;
   4. E. 581606.00, N. 4499610.68;
   5. E. 581617.20, N. 4499598.78
3. Vendi i propozuar eshte prane Stacionit te transferimit te mbetjeve urbane, pergjate rruges Bilisht – Hocisht, rreth 1km larg qytetit te Bilishtit.
4. Aktivitetet ndertimore ne pergjithesi jane burim i prodhimit te sasive te medha te mbetjeve.
5. Mbetjet gjenerohen jo vetem perkohesisht gjate fazes se ndertimit, por edhe ne menyre te vazhdueshme gjate fazes operacionale si dhe per efekt te proceseve te mirembatjtjes se ndertesave.
6. Impakti nga gjenerimi i mbetjeve eshte i perhershem dhe ne mjaft raste i pakthyeshem ne lidhje me impaktin ndaj burimeve natyrore prandaj ky impakt ndaj mjedisit duhet te pakesohet me ane te masave per menaxhimin e mbetjeve.
7. Vendi i propozuar nga Bashkia Devoll eshte nje siperfaqe e pashfrytezuar 8858 m2, e llojit kullote, me Nr. Pasurie 783/2, Z.K. 1202, me adrese Bitincke, Devoll.

Drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes Civile dhe Territorit

Marsel MULLA

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

Nr.2445 Prot **Data 24.06.2026**

RELACION
PËR
MIRATIMIN E VENDDEPOZITIMIT TË PËRKOHSHËM TË MBETJEVE INERTE

Në mbështetje të:
- Ligjit nr.139/2015 "Per vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Neni 8, Pika 2, Neni 64, pika "a";
- Ligjit Nr. 10463, date 22.09.2011, "Për menaxhimin e mbetjeve të integruara". Të ndryshuar;
- Ligjit Nr. 10433, date 16.06.2011 "Për inspektimin në Republiken e Shqipërisë";
- Ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011, "Për Lejet e Mjedisit", të ndryshuar;
- Ligjin 107/2014, date 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",
- VENDIM Nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".

Për të disiplinuar mbetjet inerte të cilat prodhohen si rezultat i proceseve të ndertimeve apo prishjeve në territorin e Bashkisë Devoll,

Kërkon:

1 - Miratimin e venddepozitimit te perkohshem te mbetjeve inerte të propozuar me poshte:

